



Pranuar / Dorezuar Prijmljeno / Prodato Received / Delivruy	26-08-2022	2	viti god year
Organ /Njesta Organ /Jednitca Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHK	4994/2022		1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.633/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.633/2022 të datës 19.07.2022, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi në fshatin

kundër organit të punësimit Komunes së Shtimes, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 26.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesë me numër A.nr.633/2022 e datës 19.07.2022 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi Nr.Prot 02/1-101 i datës 08.07.2022 i Komisionit Përzgjedhës të Komunes së Shtimes.

A r s y e t i m

Ankuesi me datë 19.07.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 4195/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër përzgjedhjes së kandidatit për pozitë Zyrtar i Lartë për Informim në Komunën e Shtimes.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 22.07.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Komunën e Shtimes. Ndërsa Këshilli më datë 28.07.2022 ka pranuar shkresat lidhur me çështjen ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike ,për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 4195/2022 e datës 19.07.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Shkrim nga ShtimeOn; Postime në rrejte sociale; Diplomën me Nr.3116 e ankuesit; Referencë apo përvoja e punës e datës 08.06.2021 nga Kosova. Info për ankuesin; Certifikatën e datës 25.02.2022 e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan; Vërtetimin me Nr.338-580 i datës 15.03.2022; Vërtetimin me Nr. 1-151-7108 i datës 03.10.2014; Certifikatën për periudhën 01.08.2018-31.01.2020; Letër Reference me Nr. 709-113 e datës 15.03.2022; Letër Rekomandim nga ankuesi; Ekstrakt nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civil me Nr. E 26199135; Shkrim nga ankuesi; Diplomë e datës 04.09.2006; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datë 22.07.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 28.07.2022; Konkursin për Zyrtar i Lartë për Informim i datës 26.05.2022 me Nr. 02/1-46; Vendimin për emërimin e komisionit përzgjedhës me numër 02 Nr.195 i datës 27.05.2022; Lista e aplikuesve dhe kriteret për përfshirjen në listën e ngushtë e datës 21.06.2022; Procesverbal i listës definitive me rezultatet e arritura në testim me shkrim, dhe intervistë me gojë i datës 04.07.2022; Përmbledhja e vlerësimeve individuale nga testi me shkrim i datës 27.06.2022; Testi me shkrim i datës 23.06.2022 për ankuesin, kandidaten dhe Emailin e datës 24.06.2022 nga Emailin e datës 08.06.2022 nga për Kërkesën për punësim të kandidates e datës 03.06.2022, Ekstrakt nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civil me Nr. E 26162041, Certifikatën e datës 30.05.2022 e lëshuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj; CV-në e kandidates Vërtetimin e datës 12.08.2015, Kontratë mbi punësim me numër 0173/2011 e datës 01.01.2011, Certifikatën shtator 2013, Diplomën me Nr. 262 për kandidaten Kërkesën për punësim të kandidates e datës 06.06.2022, Vërtetimin e datës 01.06.2022, Diplomën me Nr. 4752 për Referencë e datës 03.06.2022, Ekstrakt nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civil me Nr. E 26178386, Certifikatën e datës 03.06.2022 e lëshuar nga Gjykata Themelore në Mitrovicë-Dega Vushtrri, Vërtetimin e datës 15.09.2017, Certifikatën e datës 19.05.2018; Kërkesën për punësim të ankuesit e datës 10.06.2022 me dokumentet e bashkangjitura; Shkresë për vlerësimin e kandidatëve në intervistën me gojë; Vendimin me Nr.Prot 02/1-101 i datës 08.07.2022 i Komisionit Përzgjedhës të Komunës së Shtimes.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së është e pabazuar ankesa e ankuesit , *sepse:*

Nga administrimi i provave materiale rezulton së Komuna e Shtimes duke u bazuar në nenin 32 paragrafi 4, nenin 79, 80, 81 dhe 82 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë si dhe nenin 8 dhe nenin 10 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, më datë 26.05.2022 ka shpallur Konkursin me Nr.02/1-46 për pozitën *Zyrtar i Lartë për Informim*, për periudhë të caktuar prej 12 muaj. Në këtë konkurs ka aplikuar ankuesi i cili i është nënshtruar testit me shkrim dhe me gojë, ndaras si rezultat i përmbledhjes së vlerësimeve të testit me shkrim dhe me gojë kandidatja është përzgjedhur si kandidatja me e suksesshëm për këtë pozitë.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se kandidatja e përzgjedhur nuk ka plotësuar kushtet e konkursit respektivisht përvojën e punës, po ashtu ka pasur shkelje flagrante të kriterëve të konkursit.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 86 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, e me qëllim të vendosjes së drejt dhe të ligjshme lidhur me këtë çështje juridike-administrative, ex officio ka shqyrtuar në tërësi procedurën e rekrutimit sipas Konkursit me numër Nr.02/1-46 për pozitën Zyrtar i Lartë për Informim në Komunës e Shtimes, dhe rrjedhimisht ka konstatuar se procedura në fjalë është zhvilluar në pajtim me nenin 32 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë me të cilin është përcaktuar se: *Përjashtimisht, një pozitë e rregullt pune në Shërbimin Civil mund të plotësohet në rast të nevojës të zëvendësimit apo mungesës së përkohshme të një nëpunësi civil varësisht nga rasti, për një periudhë jo më të gjatë se 12 (dymbëdhjetë) muaj. Në këtë rast, procedurat e pranimit zhvillohen nga Njësia e Burimeve Njerëzore, në pajtim me rregullat e përcaktuara me këtë ligj për nëpunësin administrativ dhe mbështetës, përkatësisht sipas shkresave të lëndës Kolegji gjen se vlerësimi i kandidatëve është bërë në pajtim me kërkesat e përcaktuara me nenin 80 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ngase kandidatet i janë nënshtruar vlerësimit gojor dhe me shkrim për verifikimin e njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale, kështu që mbi këtë bazë Kolegji konstaton së është i pabazuar pretendimi ankimor se konkursi në fjalë është përcjellë me shkelje flagrante.*

Sipas Konkursit Nr.02/1-46 të datës 26.05.2022 për pozitën *Zyrtar i Lartë për Informim*, si kriteret të përcaktuara për këtë pozitë pune kanë qenë: *Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës, Diplomë universitare, Fakulteti i Gazetarisë ose Gjuhë dhe Letërsi Shqipe me të paktën 180 kredi/ECTS apo ekuivalente me to. Njohur në fushën e Gazetarisë apo komunikimit publik. Aftësi të arsyetimit logjik dhe të analizës dhe të paktën 2 vite përvojë pune në fushën në të cilën zhvillohet procedura.*

Lidhur me pretendimin ankimor së kandidatja e përzgjedhur nuk ka plotësuar kushtet e konkursit respektivisht përvojën e punës, Kolegji gjatë shqyrtimit të provave materiale gjegjësisht dokumentacionit të dorëzuar me rastin e aplikimit ka konstatuar se kandidatja sipas Diplomës me Nr. 4752 të datës 05.08.2019 të lëshuar nga Fakulteti i Filologjisë i Universiteti të Prishtinës "Hasan Prishtina", me datë 01.04.2019 ka përfunduar studimet themelore në programin Gazetari duke marr titullin Bachelor i Gazetarisë me gjithsej 180 kredi/ECTS, e mbi këto dëshmi rrjedhje së e njëjta ka plotësuar kriterin e arsimit, ndërsa lidhur me përvojën e punës Kolegji gjen se sipas Vërtetimit të datës 15.09.2017 të lëshuar nga Radiotelevizioni i Kosovës kandidatja në fjalë nga data 28.08.2017 deri më datë 15.09.2017 ka vijuar praktikën pranë këtij mediumi publik televiziv, kurse sipas Vërtetimit të datës 01.06.2022 të lëshuar nga Agjencia e Lajmeve " INFOKUS " dëshmohet se e njëjta nga data 01.12.2018 deri më datë 01.10.2019 ka qenë e punësuar si gazetare pranë kësaj agjencie, ndërsa sipas Referencës së datës 03.06.2022 të lëshuar nga agjencia "INDEKONLINE," rrjedh së kandidatja e përzgjedhur është në marrëdhënie pune në këtë agjenci nga data 04.10.2019 dhe vazhdon si gazetare, po ashtu e njëjta posedon Certifikatë të datës 19.05.2018 për përfundimin e suksesshëm të modulit Produksioni Multimedial të realizuar nga data 9-19 maj 2018 nga Kosovo 2.0 në bashkëpunim me Sbunker si pjesë e projektit pruAktvi, andaj nisur nga këto dëshmi Kolegji vlerëson së kandidatja e përzgjedhur po ashtu ka plotësuar edhe kriterin e përvojës së punës dhe posedon njohur në fushën e gazetarisë dhe komunikimit publik.

Po ashtu bazuar në dokumentacionin e aplikimit të ankuesit, Kolegji gjen se edhe ankuesi ka plotësuar kriteret për pozitën e shpallur mirëpo në bazë të vlerësimit të testit me shkrim dhe me

gojë, del që ankuesi ka rrit gjithsej 56.3 pikë ndërsa kandidatja e përzgjedhur ka arrit gjithsejtë 90 pikë duke u shpallur si kandidatja me e suksesshme, andaj mbi këto konstatime rezulton së pretendimet ankimore të ankueses së kandidatja nuk ka plotësuar kriteret për pozitën Zyrtar i Lartë për Informim janë të pabazuara.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.633/2022

Avdyll BEKTESHI

[Signature]
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Ardita HAXHNIKAJ-DEMI

[Signature]
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Shtimes;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Shtimes; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;

